



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCEVE
MINISTRI

1518

URDHËR

Nr 11 datë 31.01 2012

"PËR

NGRITJEN E GRUPIT TEKNIK QË DO TË PROPOZOJË KONSULENTIN, I
CILI DO TË OFROJË ASISTENCË GJATË PËRZGJEDHJES SË FITUESIT
PËR LOTARINË KOMBËTARE"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe pikës 1.5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.25, datë 11.01.2012, "Për miratimin e kritereve të vlerësimit të garës, të dokumenteve standarde dhe strukturës së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve, për dhënien e licencës për lotarinë kombëtare", Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Ngritjen e grupit teknik, që do të propozojë Autoritetit konsulentin e huaj ndërkombëtar, i cili do të asistojë Autoritetin në procedurën e përzgjedhjes së fituesit për dhënien e licencës për lotari kombëtare.
2. Grupi teknik do të ketë në përbërje të tij këta anëtarë:
 - Z. Besnik ÇOBAJ-
Drejtor i Njësisë së Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit.
Kryetar
 - Znj. Lindita RUSMALI-
Drejtoreshë e Drejtorisë së Legjislacionit ne Ministrine e Financave.
Anëtar
 - Znj. Isida KOKA-
specialiste në Drejtorinë e Legjislacionit, ne Ministrine e Financave
Anëtar.

Grupi teknik mbledh dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët te cilet duhet te jene shoqeri konsulence me eksperience ne fushen per te cilen kerkoet te ofrojne konsulencen, vlereson karakteristikat e subjekteve dhe i propozon Ministrit te Financave me cilesine e Autoritetit, kandidatin qe vlereson si me te pershtatshem per kryerjen e funksionit per te cilin do te caktohet.

Ministri I Financave mbi bazen e rekomandimit te Grupit Teknik te ngritur sipas kestij urdheri, cakton Konsulentin.

3. Konsulenti i huaj ndërkombëtar i përzgjedhur nga Autoriteti ka këto detyra:
 - Përgatit dhe asiston Komisionin e Vlerësimit te Aplikimeve ne procesin e publikimit të dokumenteve të garës;
 - Asiston Komisionin e Vlerësimit të Aplikimeve në procesin e vlerësimit e aplikimeve dhe përzgjedhjen e fituesit;
 - Asiston Autoritetin në hartimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me fituesin.
4. Kostë e konsulencës shpallet në dokumentet e garës dhe mbulohet nga aplikuesi i shpallur fitues, jashtë tarifës që do të paguajë për marrjen e licencës.
5. Cdo subjekt i interesuar, mund te dorezoje dokumentacionin ne rruge elektronike ne adresen e vene ne dispozicion ne faqen zyrtare te Ministrise se Financave, apo dorazi prane Kryetarit te Grupit teknik.
6. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për publikimin e këtij urdhëri dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.25, datë 11.01.2012, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

